

## Pjesa I

BARDHYL DEMIRAJ

### ASPEKTE TË MENDIMIT INTELEKTUAL SHQIPTAR NË SHEK. XVIII ATË GJERGJ GUXETA DHE VENDI I TIJ NË HISTORINË E ALBANOLOGJISË

"Ujët shkon e zalli rri."



At Gjergj Guxeta (1682 - 1756)

Shfrytëzoj rastin të përmend që në hyrje të këtij punimi të thukët mendimin e shfaqur shpesh kohët e fundit lidhur me (ri)vlerësimin kritik të disa figurave që i kanë dhënë tonin zhvillimit të debatit albanologjik përgjatë shek. XVIII. Është kjo një periudhë që jemi mësuar ta damkosim jo rrallë, por patëkeq, si *parashkencore*, edhe pse jemi më se të vetëdijshëm se kjo është pikërisht periudha, kur u hodhën bazat e atyre disiplinave që formëzojnë sot së bashku fushën komplekse të albanologjisë.

Sa i përket rivlerësimit të personalitetit të Atë Gjergj Guxetës, duam të theksojmë që në fillim se bëhet fjalë këtu për një shqyrtim të detajuar të trashëgimisë së tij intelektuale, e cila po përvijon dita me ditë konture të plota, falë zbulimit fatlum të veprës së tij në dorëshkrim *De Albanesium Italiæ ritibus excolendis*, vepër e cila gëzoi këtë vit dritën e botimit, duke u bërë kështu pronë e një rrathi shumë më të zgjeruar lexuesish. Përndryshe njohja po aq fatlume dhe botimi apo ribotimi i veprave të tjera të kësaj periudhe, që na kanë lënë kryesisht në dorëshkrim ish-nxënës apo ithtarë të tij të mëvonshëm, lejojnë të bëhen përsiatje të sakta lidhur me rolin që luajti kjo trashëgimi në mbarëvajtjen e filologjisë italo-arbëreshe në përgjithësi e të asaj të zhvilluar në Seminarin Arbëresh të Palermos në veçanti.

Ç'vend zë Guxeta në historinë e albanologjisë? - një pyetje kjo që vjen më së natyrshëm, po të marrim në analizë zhvillimet që përjetoi

filologjia italo-arbëreshe përgjatë shek. XVIII. Dhe studimet paraprake në këtë drejtim nuk është se mungojnë. Mjafton të përmend këtu punimet e fundit të dy kolegëve dhe miqve të mi prof. Mandalà dhe Altimari, në të cilat sendërtohet bindshëm mendimi se filologjia italo-arbëreshe përfjetoi një "kthesë vendimtare [...] në vitet 30-të të shek. XVIII, kur u themelua në Shën Benedikt në Kalabri, Kolegji Corsini (1732) dhe në Palermo Seminari Arbëresh (1734)" (Mandalà 2006 11<sup>1</sup>). Pikërisht këtë "kthesë vendimtare" jam përpjekur ta bëj objekt diskutimi në kumtesën time, duke e vështruar atë nga dy perspektiva studimi: a) në kuadrin e aktivitetit intelektual dhe social të vetë Guxetës; si edhe b) në përqasje me nivelin e debatit albanologjik në Evropën e asaj kohe. Sigurisht që për të arritur në ndonjë rezultat paraprak është e nevojshme t'i përbahemi skemës së thjeshtë e të përgjithshme të zhvillimit të një disipline shkencore çfarëdo, e cila parakupton fillimisht, krahas objektit edhe a) shfaqjen/lindjen e ideve që hedhin dritë në enigmat që fshihen në të; duke vijuar më pas b) përpilimin e një metode që mundëson mbledhjen, organizimin dhe hulumtimin e materialit (p.sh. gjuhësor) nga një këndvështrim i ri; si edhe c) përgatitjen dhe formimin adeptëve, që e thelojnë më tej atë hulli studimi; çka siguron d) vazhdimësinë e nevojshme në hulumtim, e që gjen shprehjen në përfimin e qendrave kërkimore, përkatësisht në zhvillimin e një infrastrukturë ndërinstitucionale e kolegjiale për disiplinën a disiplinat në fjalë<sup>2</sup>.

## **1. Guxeta si ideator dhe themelues i qendrës së parë dhe më të vjetër albanologjike**

Duke iu përbajtur kësaj skeme, vërejmë se themelimi i dy kolegjeve të lartpërmendor<sup>3</sup> krijoj pa dyshim kushte më se të favorshme si për përgatitjen dhe formimin e adeptëve ashtu edhe për sigurimin e një rrjedhe normale të studimit historik dhe filologjik në arealin kulturor arbëresh. E në rast se lejohemi të flasim sot për një vatër të mirëfilltë studimesh albanologjike në këtë periudhë, këtë mund ta mëtojmë pa drojë të paktën për Seminarin Arbëresh të Palermos, i cili

<sup>1</sup> Shih edhe Altimari 1984 83vv.: "La presenza in Calabria e in Sicilia di queste due importanti istituzioni [...] garanti alle comunità albanesi di queste due regioni una proficua e stimolante circolazione di opere e di idee e una cospicua eredità culturale, che ci permette anche di capire il rilevante e qualificato apporto dato, tra il XVIII e il XIX secolo, dagli intellettuali italo-albanesi all'approfondimento della specialità etnica, religiosa, linguistica e culturale della propria nazione."

<sup>2</sup> Khs. Mullin 1974 (1972) 184vv. Për zhvillimet që përfjetoi në rrjedhë të kohës albanologjia si shkencë gjuhësore historike, shih. Ölberg 1982 135vv.

<sup>3</sup> Për aktivitetin e Kolegit Grek në Romë sh. së fundi Raquez 1985 42vv.; ndërsa për atë të Manastirit të Urdhërit Bazilian të Munxifit në Sicili sh. Borgia 1942 11 vv.

u ngjiz dhe funksionoi që në fillimet e tij edhe si një qendër e filologjisë italo-arbëreshe dhe e albanologjisë në përgjithësi. Kështu, mjafton të sjellim për ilustrim këtu krahas emrit të ideatorit dhe themeluesit të tij, Atë Gjergj Guxetës, emrat e një aradhe të tërë adeptësh, ihtarësh dhe kolegësh të tij që u morën intensivisht me kërkime në fushat e historisë, kulturës e të filologjisë arbëreshe, si p.sh.: Pal Maria Prifti (/Parrini), Nikollë Filia, Nikollë Keta në shek. XVIII<sup>4</sup>; Sepë Krispi në shek. XIX apo Pal Skiro në fillim të shek. XX.

Fakt është gjithashtu që përgjatë shek. XVIII nuk ndeshim kurrkund në Evropë dhe Ballkan ndonjë qendër simotër të studimeve albanologjike, e cila do të mund të konkurronte deri diku Seminarin Arbëresh të Palermos në shumësinë dhe larminë e aktiviteteve intelektuale e sociale. Kështu p.sh. në hapësirën kompakte kulturore-etnike shqiptare në perëndim të Ballkanit përjetojmë përqapjet e para drejt një qendre filologjike aty rrëth gjysmës së dytë së atij shekulli në akademinë e Voskopojës, ku shqipja shërbeu gjithsesi thjesht dhe vetëm si mjet ndihmës pér përvetësimin më të mirë të greqishës nga ana e shqipfolësve<sup>5</sup>; ndërsa në arealin kulturor-katolik të Veriut – krahas ndonjë shkolle të improvizuar pér fillestarë, ku mësohej katekizmi edhe në gjuhën shqipe<sup>6</sup> – hasim vetëm ndërmarrje individuale, siç është p.sh. rasti i Imzot Gjon P. Nikollë Kazazit, i cili njihet tashmë në historinë e albanologjisë si autor i një doktrine të vogël shqip (Romë 1743) e në të njëjtën kohë – falë korrespondencës që mbante më Atë Gjergj Guxetën – edhe si zbuluesi i parë “Mesharit” të Gjon Buzukut<sup>7</sup>.

Ndërmarrje kryesisht të izoluara i hetojmë në këtë qindvjetësh edhe në perëndim të Evropës. I tillë është p.sh. debati albanologjik që u zhvillua në hapësirën kulturore gjermanishtfolëse, kur filozofi dhe enciklopedisti gjerman Gottfried Wilhelm v. Leibniz (në korrespondencën e tij gjatë viteve 1688-1714)<sup>8</sup> u interesua dhe fitoi njohuritë e para mbi gjuhën shqipe pér të mëtuar më pas edhe origjinën e saj prej ilirishtes; ose aty rrëth 60 vjet më vonë historiani suedez i universitetit të Halle-s Johann Thunmann (1774), i cili iu përkushtua me intensitet çështjes së origjinës së shqiptarëve, duke i parë ata gjithashtu si pasardhës të drejtpërdrejtë të fiseve ilire në Ballkanin antik.

## 2. Vepra e Guxetës si program i filologjisë arbëreshe në shek. XVIII

<sup>4</sup> Chetta 2002 (1777) § 271 vv. përcjell një listë të detajuar të nxënësve dhë mësuesve dhe rektorëve të këtij seminari deri në vitin 1776.

<sup>5</sup> Khs. Hetzer 1981

<sup>6</sup> Khs. Gjini 1992 179; Demiraj 2006 106 vv. Hetzer 1981 tij vv.

<sup>7</sup> Khs. së fundi Mandala 1994; Demiraj 2005 47vv.

<sup>8</sup> Khs. Demiraj 2001 163vv.; 2005<sup>b</sup> 13vv.

“Kthesën vendimtare” që cituam më lart e përcjellim po aq bindshëm në paletën programatike dhe në metodën e studimit që orientoi debatin albanologjik në arealin kulturor italo-arbëresh. Me njojuritë që kemi sot në dispozicion, përkatësisht me vendosjen e tyre në aksin kronologjik, rezulton të ketë pasur përsëri rolin e udhërrëfyesit apostulli ynë, ashtu siç na prezantohet në vepërzhën e tij në dorëshkrim<sup>9</sup>. Është bash ky doracak i papërfunduar, ku ngërthehen për herë të parë e në mënyrë ballore të gjithë ata faktorë që kushtëzojnë së bashku dhe i japid formë të ashtuquajturit matriks të kulturës etnike arbëreshe, si p.sh.: a) momenti historik i zhvendosjes së bashkësisë etnike arbëreshe drejt brigjeve perëndimore të Jonit dhe Adriatikut; përkatësisht hapësira etnike kompakte e dikurshme në Ballkanin perëndimor (Cap. Primo), b) mënyra e jetesës, botëkuptimi dhe kultura materiale në traditën populllore arbëreshe (Cap. Secondo), sikurse edhe c) gjuha (Cap. Terzo); dhe d) riti e besimi fetar (Cap. Quarto e Quinto).

Interes të veçantë fiton në vepër mënyra se si i kombinon Guxeta këta faktorë, si edhe metoda që ai zbaton, kur trajton një çështje të tillë, si p.sh. ajo e identitetit etnik-kulturor të arbëreshëve të Italisë. Jo më pak i rëndësishëm është edhe qëndrimi i tij ndaj gjuhës, jo vetëm si komponent themelor i kulturës etnike, por edhe si çelës metodik në shqyrtimin e problemit kompleks të etnogjenezës shqiptare. Andaj le të përqendrohem i vazhdim kryesisht me analizat dhe rezultatet që arrin Guxeta gjatë trajtimit të këtij problemi, duke ndërmarrë sipas rastit përgasjet përkatëse edhe me rezultatet e debatit albanologjik në arealet të tjera kulturorë në Evropën e asaj kohe.

## 2.1 Çështja e identitetit etnik-kulturor italo-arbëresh

Sa i përket çështjes së identitetit italo-arbëresh, do shtuar që në fillim se ajo ishte rrjedhojë e natyrshme e konfrontimit të vazhdueshëm ndërkonfesional në shtresat e klerit bashkëkohor (Bartl 1969 32vv.; Mandalà 2006 18vv.), meqë në ngulimet arbëreshe vijonte të ushtrohej sikurse dikur në trojet e tyre etnike në Ballkan riti ortodoks bizantin, ndërkohë që në mjeshtin e ri social-kulturor mbizotëronte riti katolik romak. Në këtë kuadër arbëreshët konsideroheshin, madje edhe përcmoheshin atëbotë si grekë (ortodoksë), d.m.th. skizmatikë. Meritë e pakontestueshme e Guxetës është që ai këtë çështje e ngrë në nivelin e një debati të mirëfilltë intelektual, duke e vështruar konfesionin fetar thjesht dhe vetëm si njërin ndër komponentët përbërës të atij qerthulli problematik që ngërthente identitetin etnik-kulturor i arbëreshëve.

Prashtu, Guxeta pjesëmerr në mënyrë sa aktive aq edhe

<sup>9</sup> Për njojen dhe shfrytëzimin e veprës së tij në dorëshkrim në shek. XVIII shih Mandalà 2006 14vv.

konfrontative në debat, duke vënë përballë njëra-tjetrës dy teza diametalisht të kundërta: a) e para, siç e pamë më sipër, kish të bënte me mendimin, pas gjase gjerësish të përhapur aso kohe në rrethet intelektuale e fetare të Italisë (së Jugut), sipas të cilit italo-arbëreshët janë grekë; ndërsa b) e dyta është teza që mbështet vetë Guxeta, e cila parakupton si të mirëqena marrëdhëni e drejtpërdrejtë të filacionit ndërmjet arbëreshëve të Italisë dhe popujve jogrekë që gjellin në pjesën perëndimore të Ballkanit antik, të cilët – sipas tij – nuk mund të ishin tjetër veçse maqedonasit dhe epirotët e dikurshëm.

Prima di tutto bisogna confutare la diffusa opinione di coloro che confondono questa gente con quella greca. Di certo gli Albanesi non sono greci, infatti traggono la loro origine, non dai Greci, ma dagli Epiroti e dai Macedoni. (*De albanesium*, Cap. Primo)

Gjithsesi Guxeta nuk mungon të shtojë që në rrjedhë të kohës, sidomos pas ngërthimit të këtij territori në perandorinë romake, u përftuau përzierje me racën (= gjakun) romake dhe romane<sup>10</sup>, nga e cila rezultojnë sot maqedonasit modernë apo arbëreshët.

Sicuramente il sangue latino si diffuse nelle varie parti dell’Albania abbastanza bene e i costumi splendidamente fiorirono sotto i principi cristiani. [Si dice che] Teodosio, imperatore d’Oriente, portò dalla Spagna un gran numero di suoi amici e familiari per governare varie città e genti dell’Albania. È sicuro che fino ai tempi del principe Kastriota in Albania erano famose le più nobili famiglie di Spagnoli, detti albano-spagnoli, e invincibile Eroe li ebbe come compagni valorosissimi e fedelissimi contro i turchi. Come è sicuro che tra i siculi albanesi nostrani, fino a questo momento, si trovano alcune famiglie spagnole. (*De albanesium*, Cap. Sec.)

Përballja e këtyre dy tezave përshkon fund e krye gjithë veprën, duke kushtëzuar deri diku edhe organizimin e argumenteve pro dhe kundër, në kuptimin që ato argumente negative, të cilat kundërshtonin bindshëm pseudo-tezën mbi origjinën greke të italo-arbëreshëve, Guxeta i përcjell në të njëjtën kohë si argumente pozitive që tumirin tezën mbi origjinën maqedonase të italo-arbëreshëve. Ndër to përmendim:

<sup>10</sup> Kështu, shkruan ai: “Similmente si dice che Carlo Magno, imperatore d’occidente, ha portato in Albania, dalle Gallie e dalla Normandia, non poche famiglie, anche di stirpe regale, come per esempio quelli che furono chiamati Franchi dagli Albanesi e che continuano a vivere tra gli Albanesi di Sicilia ancora oggi e la regale famiglia dei Topia, signora di Durazzo, chiamata Carlovica o Carolina perché ebbe origine dallo stesso Carlo Magno, sulla quale Carlo Topia poi fondò la fortificatissima città di Cruja, la quale sotto Skanderbeg fu capitale di tutta l’Albania e, in dialetto albanese, fu chiamata Cruja, dopo che aveva assunto il nome del suo fondatore Carlo, o Carlo Magno [...]” (*De albanesium*, Cap. Sec.)

### a) Argumenti gjeografik-historik

Sipas Guxetës arbëreshët në Sicili dhe gjetkë në Italinë e Jugut nuk janë anas në ato troje. Si moment historik që nxiti eksodin tragjik të arbëreshëve drejt brigjeve Italisë ai cilëson vdekjen e heroit legjendar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në shek. XV, një ngjarje kjo e hidhur që do të mund të sillte pasoja të pallogaritshme ndaj gjithë popullsisë shqiptare të krishterë, e cila gjëllinte atëbotë në Shqipërinë e pushtuar prej osmanëve. Sipas tij:

Gli albanesi costituiscono una parte, non esigua né di poco conto, del gregge di Cristo; essi vivono in Italia sparsi qua e là nelle diverse colonie. Li cacciò via dall'Epiro la furia dei turchi, dopo che Giorgio Kastriota Skanderbeg (a cui va somma lode), il principe più cristiano di tutta l'Albania, morì liberandoli dall'eterno terrore di costoro: grazie alla pietà dei re di Spagna e all'amicizia verso il defunto principe, essi furono accolti nei regni di Sicilia, Calabria e Puglia; e grazie allo zelo della Santa Chiesa di Roma essi furono affidati ai vari ordinamenti, sotto la protezione dei vescovi locali, per essere aiutati nel migliore dei modi. (*De albanesium*, Cap. Sec.)<sup>11</sup>

Përndryshe, atdheu origjinari i arbëreshëve shtrihej atëbotë sikurse edhe në antikitet në Ballkanin perëndimor, në veri të hapësirës jetike greke, pikërisht në trojet e fiseve të dikurshme maqedonase dhe epirote.

Sicuramente la parte occidentale della Macedonia è, un tempo, tutto l'Epiro, ora quella parte, che, confinante con la Macedonia a nord, si protende a ovest fino ai monti Acrocerauni, che sovrastano il mare Adriatico, formano in parti uguali l'Albania. Né i Macedoni o gli Epiroti sono Greci, ma dominatori dei greci, creatori dell'impero greco, principi, per cui furono detti greci, come i greci stessi dopo che l'impero Romano per iniziativa di Costantino Flaviano Augusto fu trasferito in Grecia, si vantaron di essere chiamati Romani. (*De albanesium*, Cap. Sec.)

### b) Argumenti etnografik

Botëkuptimi dhe tradita jetësore te shqiptarët janë – sipas Guxetës – krejt të ndryshme nga ato të grekëve. Kështu:

Quanto al resto, tuttavia, gli Albanesi non sono Greci anche se hanno in comune con i Greci i santissimi riti, non la lingua, non l'amore per la vita, non i comportamenti umani, infine non la stessa foggia dell'abito che in particolare le donne albanesi

<sup>11</sup> Ky skenar e nxit Guxetën ta shoqërojë atë shtegtim edhe me një motiv mistik që e ndeshim edhe sot e kësaj dite në traditën folklorike-fetare të arbëreshëve të Italisë, sipas të cilët refugjatët arbëreshë: "Sostenuti da questi beni (ritus moresque) durante la loro emigrazione, con l'aiuto di Dio un buon numero di albanesi, sotto la guida dell'Immacolatissima Madre di Dio (Deipara), apparsa in una nube durante il giorno e in una colonna di fuoco durante la notte, passarono il mare Adriatico a piedi asciutti." (*De albanesium*, Cap. Sec.)

mantengono fino a questo momento in territorio italiano. (*De albanesium*, Cap. Sec.)

Për Guxetën arbëreshët “non hanno nulla in comune con i greci sia nel modo di vivere sia nel modo di vestirsi”. Për më tepër :

La gente albanese infatti sembra nata unicamente [...] non per le lettere (letteratura), ma per usare le armi e per fare guerra, cosa che sotto Pirro, Alessandro Magno e poi sotto il Principe Skanderbeg [...] I soldati albanesi deridono la gente greca effeminata, parlano male dei suoi costumi; ma questa (fama), gonfiata finora da antiche e molteplici notizie, taccia gli albanesi di nullità e ovunque li fa chiamare rudi e illetterati. (*De albanesium*, Cap. Sec.)

duke vazhduar më pas:

Dunque in questi, e cosa ancora più grave, anche negli animi, essi discordano molto dai greci e per dirla con una sola parola: grande è l'odio, direi quasi, e naturale l'antipatia degli Albanesi verso i Greci. Per cui sono abituali, presso l'una e l'altra gente, quei vergognosi proverbi\* e quegli sciocchi insulti con i quali si colpiscono a vicenda.<sup>12</sup> (*De albanesium*, Cap. Sec.)

### c) *Argumenti kulturor-historik*

Megjithatë – shton Guxeta – arbëreshët nuk kanë munguar assesi të nxjerrin atëbotë edhe ndonjë pinjoll bëmëmadh në punë të letrave, siç është p.sh. rasti i Aristotelit:

A liberarli da questo offesa bastò lo Stagirita (= Aristoteles) principe dei filosofi, l'unico tra gli altri albanesi che si dedicarono alle lettere anche in mezzo alle armi. (*De albanesium*, Cap. Sec.)

Gjithsesi ajo mënyrë jetese e sidomos mungesa ë trashëgimisë shkrimore në gjuhën amtare – sipas Guxetës – kanë ndikuar negativisht në rrëgjimin e traditës dhe të kujtesës historike te shqiptarët. Kështu:

D'altronde della sua antichità non possono essere sufficienti i ricordi, seppur abbastanza chiari. Infatti i macedoni non ebbero la possibilità di avere lettere (alfabeto) proprie per questa lingua, adattata solo all'uso del popolo, e non consegnarono nulla alle posterità (ai posteri) se non in lettere greche e in una lingua in cui abbiamo visto coniate in greco le monete di Pirro, di Alessandro e dei precedenti re delle Macedonia e dell'Epiro; quindi (che io sappia) nessun codice in questa lingua, nessuna scrittura, sebbene quegli autori che allora decisero che solitamente le ceremonie sacre fossero espresse in lingua albanese, (cosa di cui ebbero conoscenza diretta) nei primi secoli della Chiesa, abbiano dovuto introdurre alcuni codici sacri. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

12 [Shënim i Guxetës:] Albani convincingatos Graecos: *Graa*; hoc est feminas, et *ghiaik i Delpres*, hoc est de vulpino sanguine.

përndryshe:

Da lodare sono quindi i moderni Macedoni che, ben istruiti nelle lettere latine nel Collegio de Propaganda fide, presero l'iniziativa di scrivere in questo idioma piissimi libri<sup>13</sup> ad uso della loro gente e di consegnarli ai nostri tempi nei caratteri tipografici (noti). Nel nuovo tipo di scrittura alcuni usano i caratteri latini [...] (*De albanesium*, Cap. Ter.)

**d) *Argumenti kulturor-fetar***

Guxeta përpinqet në këtë rast të saktësojë idetë e tij lidhur me pozicionin e klerit arbëresh si pjesë përbërëse e unionit kristian nën suazën e Papatit dhe të Kishës Katolike Romake. Kështu:

Continuo ad illustrare i costumi degli Albanesi; una sola sia la regola per conoscerli: la sempre giusta fede catholica degli Albanesi in Cristo [...] (*De albanesium*, Cap. Quar.)

përndryshe:

Tuttavia vivono [gli italo-albanesi – B.D.] secondo i riti greci (queste sono istituzioni sacre per loro e per la Chiesa) di cui non esiste nulla di più prezioso e di più sacro di ciò che la Grecia diffuse in tutto l'Oriente, e i profughi, avendoli ricevuti dalla vicina Chiesa orientale, sebbene fossero stati assegnati a quella occidentale e al Patriarcato romano in virtù degli antichi canoni, dall'Epiro li portarono con sé in Italia, carichi, se si può dire, come gli israeliti che andavano vagando verso la Palestina, di tutte le ricchezze dell'Egitto. (*De Albanesium*, Cap. Sec.)<sup>14</sup>

**d) *Argumenti gjuhësor***

Për Guxetën njësia gjuhësore i bashkon më së miri arbëreshët e Italisë me shqiptarët e dheut mëmë:

La storia conferma che le parlate locali (i vernacoli) sono uguali alla lingua degli Albanesi nella quale gli Italo-albanesi di casa nostra si intendono perfettamente con gli Epiroti e con i Macedoni. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

Si "propria della gente albana" kjo gjuhë konsiderohet prej tij si "barbare", sepse:

[...] consta di suoni monosillabici che, per lo più, sono tenuti uniti da una sola vocale inserita (chiusa) in un gran numero di consonanti. Perciò risulta troppo dura e giustamente inseribile

<sup>13</sup> [Shënim i Guxetës:] Catechis. Rom: in idioma albanum trans. at excusu Romæ Dictionarium latino epirotticum per Frnc. Blancum excusum Romæ typis S. Congr. De Propag. Fid.: 16[3]5. L'infallibile verità della Cat.ca Fede di Mons Pietro Bogdano Arch. di Scopia in Italia et Alban: stamp. In Venetia nel 1691.

<sup>14</sup> Më hollësishët e shqyrton këtë problem ish-nxënësi dhe bashkëkohësi i Guxetës, Zef Skiro (Mons. Joseph Schirò). Shih për këtë Demiraj 2005<sup>c</sup>.

tra le lingue barbare, propria della natura di una gente più portata alla guerra che al foro. Di questa rozza lingua non sono soliti servirsi coloro che abitano la Macedonia e l'Epiro e, al posto di essa, usano dappertutto il volgare greco o il turco, lingue che apprendono in eguale misura fin dall'infanzia; mentre usano l'albanese unicamente in casa e in guerra: in casa per usarla durante la guerra risultando essa incomprensibile alle altre popolazioni; in guerra per aumentare, anche con la lingua, la paura nei nemici. Pur nondimeno quel semplice fiato esprime sufficientemente, anche con poche parole, i sentimenti su moltissime cose. È ricca di proverbi e di modi di dire arguti e gradevoli, artisticamente coloriti da moltissime onomatopee. È sorprendente che questa lingua, dagli italo-albanesi elevata alla poesia e adattata al metro siculo e ai versi italici, risuoni con grazia e grande piacevolezza. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

Për të kjo gjuhë është e lashtë:

Considero antichissima questa lingua, non diversamente che la gente; infatti è giusto credere che essa non sia recente o che sia nata invano dopo la sottomissione della Grecia da parte dei Macedoni (*De albanesium*, Cap. Ter.)

dhe duke qenë e tillë mbetet të kryhen hulumtime rreth origjinës së saj, e cila nuk përkon me asnjëren prej gjuhëve fqinjë në Ballkan. Kështu, sipas Guxetës:

Di questa lingua infine resta da ricercare se sia propria della gente albana, o se sia dipendente e prodotta da un'altra. Infatti una moltitudine di persone la considera greca: alcuni la immaginano Illirica, altri Turca. Ma in effetti, dopo che fu fatta una comparazione tra i suoni di queste lingue tra loro, si è scoperto che nessuna di quelle due concorda con la lingua albanese; se si prendessero alcune voci dalla (lingua) greca e una o due dalle altre (lingue), (si comprenderebbe) quali (sono) quelle che la lunga familiarità degli Albanesi con quelle popolazioni confinanti introdusse nell'idioma albano. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

Guxeta nuk bashkohet në vepër as me mendimin e humanistit shqiptar Marin Barletti, i cili lidhur me shqipen "pensa che quella sia la lingua latina, passata dagli Italici agli Epiroti." Për të ndikimi latin mbi shqipen është i dukshëm, megjithatë:

Anche se non del tutto, le voci barbare mostrano sufficientemente che quanto più sono proprie di questa lingua, (tanto più) sono del tutto diverse da quella latina; le flessioni sia dei nomi sia dei verbi sono così peculiari di questa lingua che non si adattano a nessun altro dialetto. Specialmente nella coniugazione dei verbi per i quali gli Albanesi si contentano del solo modo indicativo, e dei suoi tempi del presente, imperfetto e aoristo, che è simile a quello dei greci, e dell'imperativo presente, usando molte e varie

circonlocuzioni per gli altri tempi e modi, alla maniera dei barbari. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

### 3. Mendimi i Guxetës mbi etnogjenezën e popullit shqiptar

Argumentet e radhitura më sipër, të cilët Guxeta i shfrytëzon për të nxjerrë në pah dallimet thelbësore në identitetin etnik-kulturor midis arbëreshëve dhe grekëve, i shërbejnë atij në të njëjtën kohë si gurë themeli në rindërtimin e etnogjenezës së shqiptarëve, që gjëllinin atëbotë në dy brigjet e Adriatikut dhe të Jonit. Në projektin e tij largvajtës<sup>15</sup> feksin sidomos dy faktorë:

- a) hapësira jetike e shqiptarëve në Ballkanin perëndimor, e cila përkon jo rastësish me territorin e dikurshëm të atyre fiseve jogrekë, të cilat Guxeta – sikurse shumëkush në kohën e tij, madje edhe në kohën e antikitetit (p.sh. Straboni) – i konsideron si epirotë, përkatësisht maqedonas; dhe
- b) gjuha e veçantë, e cila është “propria della gente albana” dhe si e tillë ruan në strukturën gramatikore dhe në leksik tiparet arkaikë të një gjuhe të sertë (= rozza) barbare, e cila nuk mund të jetë tjetër veçse gjuha amtare e maqedonasve dhe e epirotëve antikë, edhe pse në rrjedhë të kohës janë përfthuar ndikime dhe përzierje me gjuhët fqinjë, kryesisht me latinishten, duke marrë sot trajtat e së ashtuquajturës maqedonishte moderne (= lingua macedona odierna), përkatësisht të shqipes. Kështu, sipas tij:

[...] essendosi avuta nel frattempo una grande varietà di mescolanze con altre lingue straniere, sia nella Colchide, dove gli Albani, partendo dal Lazio, si rifugarono e dove ebbero fino a 26 lingue, cosa che riferisce Strabone, sia nella stessa Macedonia sia nell’Epiro, dove infine fissarono il loro domicilio, quanto meno essa è stata considerata latina dallo stesso Strabone. Stando così le cose, una sì grande varietà di voci, sia latine sia barbare, di

<sup>15</sup> Lidhur me këtë projekt, Guxeta shkruan sa vijon: “Ma (per sapere) come si possono chiarire queste cose, bisogna ricorrere a un passo di Strabone, dove, descrivendo l’Epiro, dice: *Non mancano quelli che chiamano Macedonia tutto quello che fino a Corcira (Corfu) è proprio di quella regione, adducendo come motivo il fatto che usano la tonsura, la lingua, la clamide e altre usanze macedoniche di questo tipo. Alcuni sono anche di doppia lingua (bilingui).* Da questo passo di Strabone derivano molti vantaggi per noi. Primo perché, al tempo di Strabone, tutto l’Epiro era detto Macedonia ed era tenuto in gran conto, per cui nessuno può attribuirci la colpa di superbia se, come Albanesi che abitano in quella parte dell’Epiro, ci reputiamo e andiamo dicendo di essere macedoni. Secondo perché sono quanto mai vere quelle cose che abbiamo affermato fin dall’inizio, e cioè che gli albanesi non hanno nulla in comune con i greci sia nel modo di vivere sia nel modo di vestirsi. È molto più utile al nostro progetto ciò che segue, vale a dire che è certo che i Macedoni hanno avuto per lungo tempo una lingua propria, detta da loro macedonica, certamente diversa da quella greca, ma non da altre lingue; e che fra l’Epiro e la Macedonia vissero certi popoli che, oltre a quella macedonica, usarono contemporaneamente un’altra lingua, conformemente a quel: “Alcuni bilingui”; ma di quale gente e di quale dialetto si trattò, a Strabone sfugge.” (*De albanesium*, Cap. Ter.)

cui è ricca l'odierna lingua vernacola degli albanesi, si andò componendo a tal punto che noi diciamo che essa non è del tutto latina, ma un misto di latino e di macedonico antico." (*De albanesium*, Cap. Ter.)

Këta dy faktorë përbëjnë në vetvete trarët mbartës të tezës që mbështet Guxeta, sipas të cilës fiset maqedone dhe epirote të Ballkanit antik, së bashku me prijësit e tyre zulmëmëdhenj si Aleksandri i Madh i Maqedonisë dhe Pirroja i Epirit, janë pararendësit historikë të shqiptarëve të sotëm. Fakt është që kjo tezë gjëzoi përkrahje të fuqishme dhe u zhvillua në detaj në letërsinë shkencore arbëreshe të shek. XVIII-XIX, duke u ngjizur më vonë si faktor identifikues kombëtar në programin ideologjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare<sup>16</sup>. Por a është Guxeta gjetësi i kësaj teze? Kësaj pyetjeje nuk jemi ende në gjendje t'i përgjigjemi shterueshëm, edhe pse gjendet ndonjë tregues që na shtyn thellë në kohë, të paktën deri në shekujt XV-XVII. Është fjala këtu për origjinën *arbëreshe*, përkatësisht *epirote* dhe/ose *maqedone* që nuk mungojnë ta theksojnë – madje me mburrje – brezat e parë të shkrimitarëve dhe eruditëve shqiptare që vijnë prej arealit kulturor të Veriut, si p.sh. Marin Barleti, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani etj.<sup>17</sup> Parë nga kjo perspektivë besojmë se nuk jemi larg së vërtetës në rast se përsiasim që kemi të bëjmë këtu me mendimin intelektual shqiptar më të hershëm dhe më afatgjatë që njohim deri më sot, pasi hyri si i tillë edhe në programin ideologjik të lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare<sup>18</sup>.

Në këtë rast roli i Guxetës rezulton të jetë i dyfishtë: nga njëra anë si përcjellës mendimit intelektual shqiptar të kohës, e nga ana tjeter si nxitës i shqyrtimit të mëtejshëm të këtij problemi në mjedisin kulturor italo-arbëresh, duke pjesëmarrë edhe vetë në debat. Kështu, ai nuk ngurron t'i pleksë ngushtësisht faktorët 'hapësirë' dhe 'gjuhë' që përmendëm më lart, duke përdorur si çelës metodik analizën gjuhësore të toponomistikës antike të Ballkanit. E tillë është p.sh. "la spiegazione

<sup>16</sup> Shih më hollësisht Mandalà 2006 18vv.

<sup>17</sup> Si dëshmi e hershme do vështruar edhe thënia e famshme e prijësit legjendar shqiptar Gjergj Kastrioti: "Se le nostre croniche non mentiscono noi ci chiamano epiroti."

<sup>18</sup> Faktin që etnonimi diturak 'maqedon' së bashku me atë 'epirot' ka mbizotëruar së lashti mendimin intelektual shqiptar, autor i këtyre radhëve e shpjegon paraprakisht: a) me admirimin dhe respektin që gjëzonte në mesjetë gjeografi aleksandrin Ptolemaios (= lat. Ptolemeus), si më i hershmi autor i antikititet të vonë që e cakton fisin e *Albanoi*-ve në hinterlandin e Durrësit, pikërisht në provincën e atëhershme romake të Maqedonisë (shek. II e.j.); dhe a) me emërtimin e njësisë administrative kishtare *Provincia e Maqedonisë* me seli në Ohër, e cila shtrihet në perëndim deri në brigjet e Adriatikut duke përfshirë për një kohë edhe dioqezat sufragane të Vlorës, Durrësit dhe Lezhës.

della città di nome *Pella*, in Macedonia, che fu patria di Alessandro Magno e di suo padre Filippo.” Kështu, sipas Guxetës:

Sicuramente albania è *Pella*, che in latino si traduce *Equa*, cioè *Cavalla*, e probabilmente con il termine *Equa*, secondo i loro costumi i Macedoni chiamavano quella città in ricordo forse di una bellissima e straordinaria Equa, confinante con la Tessaglia di Macedonia, non diversamente dall’Epiro che fu madre fecondissima di cavalli e di cavalle straordinarie, che eccellevano su tutte le altre e, una volta morte, erano tenute in grande onore. (*De albanesium*, Cap. Ter.)<sup>19</sup>

A është bindës për studiuesin e sotëm ky interpretim gjuhësor, përkatësisht vetë teza mbi origjinën (epirote-)maqedonase të shqiptarëve? Përgjigja ndaj kësaj pyetje mund të jetë e ndryshme. Dikush mund ta marrë atë thjesht si provokuese dhe me buzën në gaz do të nxitojë të shtojë pa të keq, që deduktime dhe rindërtimë të kësaj natyre i takojnë më fort së ashtuquajturës periudhë *parashkencore* në ecurinë e debatit albanologjik. Shumëkush është megjithatë i prirur që t’i japë kësaj pyetjeje dyfishe një përgjigje negative, duke mëtuar:

a) se interpretimi gjuhësor është thjesht dhe vetëm një asociacion tingullor krejt i rastit midis oronimit antik *Pella*, si vendlindja e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, dhe emrit të përgjithshëm *pelë “cavalla”*; ndërsa

b) vetë teza mbi origjinën (epirote-)maqedonase të arbëreshëve nuk është gjë tjetër veçse një asociacion logjik, apo një pseudo-identifikim – i cili ndërvar në mënyrë fiktive faktorët ‘kohë’, ‘hapësirë’ dhe ‘gjuhë’, në kuptimin që shqiptarët, duke qenë anas në trojet e tyre etnike në Ballkanin perëndimor e që flasin një gjuhë të krejt të ndryshme nga popujt fqinjë, atëherë duhet t’i vendosim në marrëdhënie filacioni me njërin a disa ndër popujt jogrekë në pjesën perëndimore të Ballkanit antik, të cilët për Guxetën janë padyshim maqedonasit me (pinjollët e tyre) epirotët.

Gjithsesi të njëjtën pyetje – sa të thjeshtë, aq edhe të vështirë – mund ta shtrojmë edhe sa i përket tezës së ashtuquajtur *shkencore* që pranohet sot në shumicë në albanologji, sipas së cilës shqiptarët qenkan pasardhësit e atyre popullsive ilire që paskan zotëruar në antikitet trojet perëndimore të Ballkanit, e që qëndruakan në marrëdhënie farefisnie gjenetike edhe me epirotët. Edhe kjo tezë mbështetet në instancë të fundit në po ata faktorë, që lexojmë në vepërzan e Guxetës. Dhe këta janë:

<sup>19</sup> Për më tepër, shkruan Guxeta: “Allo stesso modo in seguito, in ricordo del celeberrimo *Bucefalo*, domato da Alessandro, è sicuro che fu fondata un’altra città, del tutto nuova, che fu chiamata *Bucefala*.”

a) hapësira jetike e shqiptarëve të sotëm në Ballkanin perëndimor, e cila përkon jo rastësish me territorin e dikurshëm të atyre fiseve jogrekë, të cilat shumëkush sot, sikurse edhe në kohën e antikitetit i konsideron si *Illyri (proprie dicti)* – por në këtë rast citohen autorë të tjerë antikë (p.sh. Plini i Vjetër); dhe

b) gjuha e veçantë, e cila është “propria della gente albana” dhe si e tillë ruan në strukturën gramatikore dhe në leksik tiparet e një gjuhe barbare, që nuk mund të jetë tjetër veçse gjuha amtare e ilirëve dhe e epirotëve antikë, edhe pse në rrjedhë të kohës janë përfshuar ndikime dhe përzierje me gjuhët fqinjë, kryesisht me latinishten, duke marrë trajtat e një si të thuash “ilirishteje moderne”.

Ideatorin e kësaj teze, që citohet shpesh dhe bujshëm në historinë e albanologjisë, patëm rast ta përmendnim më lart. Është filologzofi dhe erudit gjerman Leibniz, një thuajse bashkëkohës i Guxetës, i cili në fakt shkruan vetëm për “[...] un livre & un Dictionnaire de la Langue Albanoise; par là nous apprenons quelle étoit la langue des anciens Illyriens. ...” (*Opera omnia* V, f. 494). Ishin këta librat e dy autorëve shqiptarë të gjysmës së parë të shek. XVII, të cilët i kumtuan Leibniz-it tiparet themelore të shqipes si një gjuhë e mëvetësishme në Ballkanin perëndimor: *Doktrina e Krishterë* e Pjetër Budit, e sidomos *Fjalori latinisht-epirotisht*, vepra e parë e mirëfilltë albanologjike që njohim deri më sot me autor Frang Bardhin. Leibniz-i sigurisht nuk mësoi as prej Pjetër Budit dhe as prej Frang Bardhit origjinën ilire të shqipes. Ata vetë e quajnë veten sipas rastit (*i arbëreshë, epirot ose i dheut të Macedoniesë*). Por në librat e tyre ai kërkoi dhe gjeti informacionin e nevojshëm për mëvetësinë dhe përhapjen gjeografike të shqipes si gjuhë që flitej në perëndim të Ballkanit. Përndryshe ne jemi të mendimit që origjinën ilire të shqipes ai e përsiati thjesht dhe vetëm, sepse kishte një tjetër koncept mbi hartën demografike të Ballkanit antik.

#### 4. Vendi i Guxetës në historinë e albanologjisë

Në rast se lejohemi së fundi të ballafaqojmë këta dy dijetarë nga perspektiva e historisë së mendimit albanologjik, nuk bëjmë gjë tjetër veçse përzasim rezultatet e arritura prej tyre, parë këto si fryt i shkallës së njojjes dhe i debatit albanologjik në dy areale kulturore, që deri atë kohë nuk rezulton të kenë pasur kontakte të ndërsjella, përvèç shkëmbimit të ndonjë libri të rrallë. Të dy dijetarët i bashkon me njëri-tjetrin në radhë të parë operacioni – do të thonim – logjik, parë ky si bashkëlidhje, përkatesisht ndërvarësi kausale e faktorëve ‘kohë’, ‘hapësirë’ dhe ‘gjuhë’. Që rezultatet e tyre janë të ndryshme – siç mund të ishin edhe të njëjtë – këtë dallim mund dhe duhet ta përcjellim sot si sipërfaqësor, sepse ka të bëjë thjesht dhe vetëm me pozicionimin e njërit apo tjetrit dijetar

ndaj ndërliksjes së marrëdhënieve etnike në pjesën perëndimore dhe qendrore të Ballkanit antik, për të cilin dëshmitë gjuhësore të mirëfillta mungojnë<sup>20</sup>.

Dallimet konsistonjë më fort në aktivitetin intelektual dhe social të njërit dhe tjetrit dijetar lidhur me kërkimin albanologjik në përgjithësi. Kështu, Leibniz-i gjatë trajtimit të historisë së popullit shqiptar, por edhe të gjuhës shqipe, vepron kryesisht si enciklopedist, ndërsa Guxeta me vepërzën e tij sendërttoi një projekt afatgjatë të kërkimit albanologjik me pretendime të mirëfillta shkencore në të ardhmen. Në këtë kuadër edhe fjala përmbyllëse e këtij projekti:

Allo stesso modo crediamo di fare (forse) una cosa gradita agli studiosi dell'antichità e a coloro ai quali, assieme agli uomini più eruditi, piace fare ricerche sulle origini delle lingue. (*De albanesium*, Cap. Ter.)

ruan sot e gjithë ditën në shkencën tonë të shenjtë të albanologjisë vlerën e fjalës apostolike.

## BIBLIOGRAFI

Altimari, Francesco

- Il movimento culturale della *Rilindja* e il Collegio di S. Adriano nella prima metà del secolo XIX, nr. 11 i serisë “Quaderni di Zjarri” 11 [1984]. Cosenza
- Studi linguistici arbëreshë, nr. 12 i serisë “Quaderni di Zjarri” 1988

Bartl, Peter

- Über den Ritusstreit in den Italo-Albanischen Gemeinden Kalabriens im 18. Jahrhundert, në: “*Studia albanica monacensis. In memoriam Georgii Castriotae Scanderbegi 1468 – 1968*”, München 1969, f. 32-46

Blanchus, Franciscus (= Frang Bardhi)

- *Dictionarum latino-epiroticum*, Romæ 1635

Borgia, Nilo

- *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: “Roma e l'Oriente” 3 [1913] (5) 97-117, 159-166
- *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: “Roma e

<sup>20</sup> Një përpjekje të parë për të bashkërenduar rezultatet e arritura në këta dy areale i hasim në fillim të shek. XIX në veprën e italo-arbëreshit Angelo Masci: *Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della natione Albanese*, Napoli 1807. Shih më hollësisht për këtë Demiraj 2002 115vv.

l’Oriente” 3 [1913] (6) 209-231

- *Contributo alla storia del rito greco in Italia*, në: “Roma e l’Oriente”, 4 [1914] (7) 272-285; 340-352
- *I monaci basiliani d’italia in Albania. Appunti di storia missionaria (Secoli XVI-XVIII)*. Periodo secondo, Roma 1942

Chetta, Nicolò (= Nikollë Keta)

- *Tesoro di Notizie de’ Macedoni*. (1777 – ms.). *Introduzione di Matteo Mandalà. Trascrizione di Giuseppe Fucarino*; Contessa Entellina 2002

Crispi, Giuseppe (= Sepë Krispi)

- *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle Colonie Albanese di Sicilia*, Palermo 1853.

Demiraj, Bardhyll

- *Si të lexojmë Leibniz-in*, në: “Seminari ndërkombetar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Prishtinë-Prizren, gusht 2000)”, Prishtinë 2001, S. 359-371.
- Sprovë për një lexim kritik të materialit gjuhësor në veprën e Angelo Masci-t, in: „*Studi in onore di Antonino Guzzetta*” (bot. F. Di Miceli – M. Mandalà), Palermo 2002, S. 115-131
- *Viti i zbulimit të ‘Mesharit’ të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në: “*βίβλος*” 26 [2005<sup>a</sup>] 47-53
- *Leibniz’ Stellung in der Geschichte der Albanologie*, in: “*Festschrift für Wilfried Fiedler*”. Hamburg 2005<sup>b</sup>, f. 13-31.
- *Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, in: “*Studime*” 12 [2005<sup>c</sup>] 52-67, Prishtinë 2005.
- Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “*Doktrina*” e tij; Prishtinë 2006
- “*Un manoscritto rituale in nostra lingua*” che dovrebbe essere ricercato, në: “*βίβλος*” (- në shtyp)

Guzzetta, Giorgio

- Memoriale del P. Giorgio Guzzetta, indirizzato al Papa Benedetto XIV, in cui si domanda l’approvazione delle opere realizzate dallo stesso, in: “*Oriente Cristiano*” Anno XXV nn. 2-3; Aprile – Settembre 1985, f. 138 vv.
- Testamento del Padre Giorgio Guzzetta, në: “*Oriente Cristiano*” Anno XXV nn. 2-3; Aprile – Settembre 1985, f. 143vv.
- L’osservanza del rito preso gli Albanezi d’Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa (= titulli i originalit në dorëshkrim: *De Albanesium Italiæ ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint*), Palermo 2007.

Gjini, Gaspër

- Ipeshkëvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Zagreb. 199, f. 2
- Fortino, Italo Constante
  - Funzione dei seminari di rito Greco di Calabria e di Sicilia nella formazione del laicato Italo-Albanese, në: "Oriente Cristiano" Anno XXV nn. 2-3; Aprile – Settembre 1985, 54-76
- Hetzer, Armin (bot.)
  - Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis (1770), Hamburg 1981
- Mandalà, Matteo (= Mateo Mandala)
  - *La lettera inedita* (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Gazzetta, në: "βίβλος" 1994
  - *Nicolò Chetta; Nel bicentenario* (1803-2003), Palermo 2003
  - *Luca Matranga, E Mbsuame e krështerë* (a cura di Matteo Mandalà), në serinë: "Albanica", nr. 21, Caltanissetta 2004
  - Vepra e pabotuar e At Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII, në: "Studime Filologjike" 1-2 [2006] 11-41
- Masci, Angelo
  - Discorso sull'origine, costumi e stato attuale della nazione albanese, Napoli 1807.
- Morelli, Domenico
  - P. Giorgio Gazzetta e gli inizi del Seminario Siculo-Albanese di Palermo, në: "Oriente Cristiano" XXV nr. 2-3, Aprile-Settembre 1985, S. 77-93
- Mullin, Nicholas C.
  - Die Entwicklung eines wissenschaftlichen Spezialgebietes: die Phagen-Gruppe und die Ursprünge der Molekularbiologie, në përbledhjen "Wissenschaftssoziologie" (bot. Peter Weigart) bl. 2, Frankfurt am Main 1974<sup>2</sup> (engl. 1972<sup>1</sup>), f. 183vv.
- Ölberg, Hermann
  - Die Entwicklung eines Paradigmas, në: "Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft" bl. 50 (Sonderheft), Innsbruck 1982, f. 135-153
- Petrotta, Gaetano
  - *Studi di storia della letteratura albanese. Popolo lingua e letteratura albanese*, Palermo 1931
- Raquez, Olivero
  - Contributo del Collegio Greco di Roma alla formazione culturale-religiosa delle Colonie Italo-Albanesi di Sicilia, në: "Oriente

Cristiano" Anno XXV nn. 2-3; Aprile – Settembre 1985, f. 42-53

Rodotà, Pompilio

- *Dell'origine, progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*, vol. III, Roma 1758

Rrota, P. Justin

- *Monumenti mā i vjetri i Giûhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)*. Shkodër 1930.

Schirò, Paolo

- *Më i Vjetëri Shkronjës Shqiptar i Njohur*; 1555, në: "Dielli" Boston, 18 mars 1910, nr. 51, f. 1

Sciambra, Matteo

- *Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese*, në: „Shëjzat (le pleiadi)“ 11 [1967] (1-4) 134-156, 281-301, 393-434

## SUMMARY

The article focuses on the key role Giorgio Guzzetta played in Albanology. In his analysis the author stresses the importance of Guzzetta's researches included in an European contemporaneous context.

Based on different arguments Demiraj also offers a detailed description of the ethnic cultural identity of the Italo-Albanians otherwise known as Arbëresh.

Guzzetta's contribution laid the main basis of the later philological Italo-Albanian studies.